



BASHKIA MIRDITË
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
JANAR 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	05.01.2024	Kërkesë për Informacion	09.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion drejtuar bashkisë Mirditë ju informojmë se;</p> <p>1. Bashkia Mirditë ka në strukturën e saj organike, 1 (një) person që mbulon pozicionin e Kordinatorit Vendor Kundër Dhunës në Familje (KVDHF) me detyrimin dhe përgjegjësinë për të përmbushur detyrat e përcaktuara në VKM nr. 334, datë 17.02.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, të reflektuara edhe në përshkrimin e punës së tij/saj.</p> <p>2. Gjatë periudhës 2018-2023, rastet në të cilat titullari I policisë së shtetit ka njoftuar menjëherë koordinatorin për referimin e rasteve të dhunës në</p>	E plotë	Pa pagesë

				<p>marrëdhëniet familjare ka ardhur gjithmonë duke u përmirësuar, ku në vitin 2018 përqindja e njoftimit të koordinatorit ka qënë diku tek 45% dhe në vitin 2023 kemi arritur diku tek 85%-90% pasi titullari aktual për çdo rast dhune në marrëdhëniet familjare që paraqitet në komisariat njofton koordinatorin vendor.</p> <p>3. Në territorin e bashkisë tonë nuk kemi të ngritura qendra sociale të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje, as struktura të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve, kjo si pasojë e mungesës së fondeve si një bashki me buxhet të vogël.</p> <p>4. Nuk kemi patur raste të cilat mund të kenë kërkuar bashkëpunim me Shërbimin e Provës.</p> <p>Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!</p>		
2	08.01.2024	Kërkesë për Informacion	17.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, me nr.39 Prot, datë 05.01.2024, Kërkesë për Informacion, e protokolluar në Bashkinë Mirditë me nr.76 Prot, datë 08.01.2024 ju informojmë se: Njoftimet për Konsultimet Publike, janë bërë nëpërmjet publikimit në faqen Web të Bashkisw www.bashkiamirditw.gov.al, si dhe në rrjetet sociale që bashkia disponon. Gjithashtu njoftimi është afishuar në ambientet publike të bashkisë dhe të gjitha njësive administrative.</p> <p>Referuar aktorëve qe kanë marrë pjesë në konsultime, mund të përmendim pjesëmarrjen qytetare, përfaqësues të bizneseve vendase, përfaqësues nga Dioqeza Rrëshen, përfaqësues të subjekteve vendore (DSHP, ZVA).</p>	E plotë	Pa pagesë

				Komentet e paraqitura nga aktorët e sipërpërmendur, janë marrë në shqyrtim nga Komisioni i ngritur për konsultimet publike, mbi hartimin e buxhetit dhe paketës fiskale, duke përfshirë në buxhetin e vitit 2024 më prioritetet. Sesionet e Konsultimit Publik janë zhvilluar përkatësisht në cdo njësi administrative të Bashkisë Mirditë dhe kanë zgjatur rreth 2 orë cdo sesion.		
3	14.01.2024	Kërkesë për Informacion	23.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion drejtuar Bashkisë Mirditë ju informojmë se;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlera e ndihmës sociale për femrat e dhunuara është zero lekë. 2. Buxheti I bashkisë për dhunën në familje nuk është I ndarë si zë më vete por sipas rasteve trajtohet me VKB përkatëse, të hartuara në bazë të raportit social të ASHSAK(Agjencia e Shërbimit Social, Artit dhe Kulturës) nga fondi rezervë I planifikuar në buxhet. 3. Nga periudha 2021-2023 pranë Bashkisë Mirditë janë trajtuar me Urdhër Mbrojtje 12 raste të viktimave të dhunës në familje, përkatësisht për vitin 2021-6 raste me UM, VITI 2022-4 raste me UM dhe për vitin 2023-2 raste me UM. 	E plotë	Pa pagesë

4	16.01.2024	Kërkesë për Informacion	24.01.2024	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, drejtuar Bashkisë Mirditë ju informojmë se:</p> <p>Referuar pyetjes së parë, për vitin 2023 Bashkia Mirditë ka zhvilluar gjithsej 16 konsultime publike, ku pjesë e këtyre konsultimeve kanë pasur mundësinë të jenë qytetaret, perfaqësuesit e biznesit, gjithashtu edhe përfaqësues të OJF-ve. Forma e konsultimit ka qene takimi publik.</p> <p>Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në Bashkinë Mirditë është: znj. Nertila Beqiri.</p> <p>Adresa Elektronike : nertila.beqiri@bashkiamirdite.gov.al,</p> <p>Bashkia Mirditë nuk ka koordinatorë për shoqërinë civile.</p> <p>Si organe këshillimore që funksionojnë pranë bashkisë Mirditë, mund të përmendim, Këshilli Vendor Rinor, Komisioni Vendor për Dhënien e Medaljeve dhe Titujve të Nderit, Komiteti Drejtues i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës Në Familje, ku pjesë e këtij Komiteti janë edhe Përfaqësues nga 4 OJF që operojnë në territorin e Bashkisë sonë.</p> <p>· Për gjatë vitit 2023 kemi pasur disa grupe të përbashkëta punë me pjesëmarrjen e OJF, ku përmendim fushata sensibilizuese lidhur me: Fushatën Ndërgjegjësuere për Parandalimin e Dhunës në Familje, Fushatë Ndërgjegjësuere kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, etj. Gjithashtu dhe bashkëpunimi me UNOPS në kuadër të Projekteve si : DigiCult, Cultour, Kultura për Zhvillimin e Qëndrueshëm, ku UNOPS ka qenë në rolin e donatorit, pra ka zgjedhur Bashkinë Mirditë për aplikimin e këtyre projekteve, por si pjesë e grupit të punës, si pikë kontakti kemi pasur punonjës në mënyrë që të ndihmonte si dhe me koordinimin e punës dhe</p>	E plotë	Pa pagesë
---	------------	-------------------------	------------	--	---------	-----------

				<p>kontakteve. Lidhur me trajnimet e stafit të Insitucionit tonë mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF-ve, theksojmë se ndër vite, janë përfshirë vazhdimisht në trajnime të organizuara si nga institucionet po ashtu dhe nga organizata të ndryshme. Bashkia Mirditë nuk ka licensuar ndonjë OJF për shërbime të caktuara.</p> <p>Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !</p>		